



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 060 - 23987/23

Klinë, datë: 20.07.2023

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Ujmirë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "ALI KRASNIQI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Dush, Gjurgjevik i Madh, Çabiq, Zabërgjë dhe Doberdol. Tubimi u mbajt me datë 15 qershor 2023 dhe filloi në orën 19:30, ku morën pjesë: 15 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave ka bërë një prezantim në pika të shkurtra projektet e planifikuara infrastrukturore në këto zona e lartcekura.

Drejtori Berisha informoi se në Ujmirë do të fillojë shumë shpjetë asfaltimi i rrugëve lokale faza III-të, në vlerë 35,000€ si dhe asfaltimi i rrugëve lokale Çabiq-Carravik faza II-të, në vlerë 65,000€.

Pas drejtorit Berisha, fjala ju dha të pranishmëve, banorëve nga Ujmiri, Dushi, Gjurgjevik i Madh, Çabiqi, Zabërgja dhe Doberdoli.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Sokol Krasniqi – Fshati Çabiq, Kërkon ndriçim publik sa i përket rrugës kryesore Çabiq -Zabërgjë, si dhe disa zona të degëzuara nga rruga kryesore.

Sejdi Hodaj - Fshati Zabërgjë, kërkesë për rregullimin e rrugës me zhavorr ose asfalt sepse është e vështirë për t'u kaluar, 800 metra janë për t'u shtruar nga drejtimi për Gllarevë.

Kemi problem me tension të rrymës, afro pesëmbëdhjete familje jemi me probleme të tilla. Kemi thirrur KEDS-in por deri më tani asgjë. Të gjitha shtyllat janë të dobëta, që nga vitet 1970 ato kanë defekte të herëpashershme, dhe për më tepër jemi të lidhur në një trafo që është e mbingarkuar dhe prandaj kemi luhatje të tensionit.

Fatmir Millaku - Fshati Ujmirë, kërkon rinovim të rrjetit të KEDS-it, si dhe asfaltimin e rrugës të ambulancës, që është afro 30-40 metra.

Ukë Gashi – Fshati Ujmirë, kërkon që në pjesën ku hidhen mbeturinat inerte, të rrafshohet zona me mbeturina, dhe me vullnet të tij dëshiron të investojë në hapësirë të gjelbër me pemë dekorative dhe kërkon që edhe komuna ta ndihmojë me rrafshim të zonës dhe me zhavorr.

Masar Marmullaku – Fshati Dush, kërkon shtrimin e një rrugice 70 metra në fshatin Dush, lagjja "Sejdiu". Po ashtu, kërkon të bëhet ndriçimi publik në fshatin Dush.



Pasi banoret parashtruan të gjitha kërkesat, **drejtori i Shërbimeve Publike, z. Qendim Millaku** i cili ishte i pranishëm në këtë takim informoi se komuna ka ndarë rreth 100.000 euro për projektet e ndriçimit publik, janë nisur disa projekte dhe po punohet në paramanat e projektit. Të gjitha fshatrat do të përfshihen me theks të veçantë rrugët kryesore të fshatrave dhe lagjet.

Drejtori Millaku, gjithashtu u përgjigj qytetarëve të pranishëm lidhur me shqetësimet për tensionin e rrymës nga KEDS. Ai theksoi se në planin e fundit të marrë dje, ka parë se lokaliteti i Zabërgjës është i përfshirë në investimet e rregullimit të tensionit të rrymës, dhe vetëm ka mbetur që të lëshohet leja nga kjo drejtori që të fillojnë punimet së shpejti për nëntë fshatra gjithsej të përfshira në listën e KEDS-it.



Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt Ujmirë, në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “ALI KRASNIQI”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Dush, Gjurgjevik i Madh, Çabiq, Zabërgjë dhe Doberdol, morën pjesë: 15 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	15
Total:	15

Takimi përfundoi në orën 20:24.

Procesmbajtësi:
Nikson Daka

Klinë, datë: 20.07.2023